



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2449/Prot.

Tiranë, më 20.10.2025

VENDIM

Nr. 308, datë 10.10.2025

**“PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM TIRANË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar (në mungesë)
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.10.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2449 prot., datë 02.10.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me relator znj. Ledina Riza, si dhe referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim Këshilli)* është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, bazuar në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe efijencës.
2. Me Vendimin nr. 264, datë 11.10.2022, *“Për caktimin e zotit Arens Çela, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, në pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”*, Këshilli ka vendosur caktimin e prokurorit Arens Çela në detyrën si Drejtues në këtë zyrë prokurorie për periudhën nga data 11.10.2022 deri në datën 10.10.2025.

Sipas këtij vendimi, mandati 3-vjeçar në detyrën si Drejtues në këtë zyrë të prokurorisë për z. Arens Çela plotësohet në datën 10.10.2025.

3. Pranë Këshillit është administruar Shkresa me nr. 8519 prot., datë 03.04.2025, me të cilën prokurori Arens Çela, me detyrë Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka paraqitur kërkesë për të kandiduar për një mandat të dytë në pozicionin e Drejtuesit të kësaj zyre prokurorie. Kërkesa bazohet në nenin 52, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar *(në vijim Ligji për Statusin)* dhe është paraqitur brenda afatit ligjor.
4. Në përputhje me nenin 52, pika 3, të Ligjit për Statusin, kur Drejtuesi i prokurorisë në detyrë kandidon për riemërim, i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës, jo më vonë se 3 (tre) muaj përpara mbarimit të mandatit të parë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 32, pikat 2-7, të Ligjit për Statusin. Ndërsa, referuar nenit 52, pika 4, të ligjit, Drejtuesi riemërohet për një mandat tjetër vetëm nëse kalon me sukses verifikimin, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji, dhe nëse vlerësimi për veprimtarinë si kryetar (drejtues) dhe magjistrat është të paktën *“Shumë mirë”*.
5. Për rrjedhojë, për shkak të rikandidimit, prokurori Arens Çela i është nënshtuar verifikimit të pasurisë dhe figurës si dhe vlerësimit etik dhe profesional si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
6. Me Vendimin nr. 89, datë 06.05.2025, *“Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për t’u riemëruar në pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, zotit Arens Çela”*, Këshilli ka filluar procedurat administrative të verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit.
7. Me Vendimin tjetër me nr. 256, datë 26.11.2024, *“Për miratimin e programit që përcakton listën e prokurorëve dhe kryetarëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit 2025”*, i ndryshuar, Këshilli ka miratuar listën e prokurorëve dhe drejtuesve

të zyrave të prokurorisë që do t'i nënshtrohen vlerësimit etik dhe profesional gjatë vitit 2025, ndër të cilët edhe prokurori, z. Arens Çela.

8. Dy proceset në fjalë zhvillohen nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe konsiderohen komplekse për shkak të ndërveprimit dhe sigurimit të informacionit nga institucionet e tjera shtetërore. Për këto arsye, procedurat e mësipërme të verifikimit dhe vlerësimit etik dhe profesional janë ende në realizim e sipër nga ana e Këshillit.
9. I ndodhur në kushtet e mësipërme, me plotësimin e kohës së mandatit të drejtuesit aktual në datë 10.10.2025, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës duhet të marrë masat e nevojshme për të garantuar funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
10. Ruajtja e vazhdimësisë në ushtrimin e detyrës së mësipërme bëhet nëpërmjet zbatimit të instrumentit të *caktimit të përkohshëm* të një prokurori në këtë detyrë. Në procedurën për caktimin të përkohshëm të drejtuesit janë mbajtur parasysh parashikimet ligjore dhe nënligjore, si më poshtë:

Në nenin 59, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet se :

"1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:

- a) caktimit në pozicione të tjera;*
- b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji."*

Në nenin 3, të Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019, "Për miratimin e Rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", e ndryshuar, të Këshillit, përcaktohet se:

"1. Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm."

11. Përsa më sipër, duke qënë se periudha e plotësimit të kohës së mandatit për drejtuesin aktual të Zyrës së Prokurorisë Tiranë, prokurorin Arens Çela plotësohet në datë 10.10.2025, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë dhe mbarëvajtjes së punës në këtë prokurori është e nevojshme që, Këshilli të miratojë vendimin për caktimin e përkohshëm në detyrën në fjalë të z. Çela, për një periudhë 3-mujore.

12. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke vlerësuar rrethanat e mësipërme dhe pasi bëri verifikimet përkatëse pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, ku u konstatua se prokurori Arens Çela nuk ka masë disiplinore në fuqi, bazuar në sa më sipër, i propozoi Këshillit që, prokurori Arens Çela të *caktohet përkohësisht* të ushtrojë funksionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për periudhën nga data 11.10.2025 deri në 11.01.2026.

13. Për këtë periudhë, prokurori Arens Çela do të përfitojë pagën e drejtuesit të zyrës së prokurorisë, sipas ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës, në nenin 59, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 184, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe nenin 3, të Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019, “Për miratimin e Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e përkohshëm të prokurorit Arens Çela në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për periudhën nga data 11.10.2025 deri në 11.01.2026.
2. Për periudhën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, prokurori Arens Çela të paguhet me pagën e pozicionit ku është caktuar përkohësisht.
3. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe prokurori Arens Çela.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 10.10.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR

Erind Germenji

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Zeqir Hoda

ANËTAR

Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla

KOPJE WEB